Numër: 01-462
Datë: 29.05.2026

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e II- te mbajtur me datë 29.05.2026 nxjerrë këtë:

## VENDIM

1. **Riakreditohet dhe rivalidohet**, KOLEGJI NDËRKOMBËTAR PËR BIZNES DHE TEKNOLOGJI "UBT" SH.P.K. RR. "UKË BYTYQI" NË PRIZREN Republika e Kosovës për periudhën pese (5) vjeçare, përkatësisht nga data 01.09.2026 (5 vite) deri 30.08.2031me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

    1.1. **Teknik i laboratorit mjekësor,** Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji Kualifikim Kombëtar të Kombinuar (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional deri me njëzetepesë (25) nxënës në një klase, dhe mund të ofroj deri ne katër (4) klase brenda vitit, që në total bëjnë 100 nxënës (4x25=100) nxënës për një vit shkollor.

    1.2. **Bashkëpunëtor profesional i infermierisë,** Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji Kualifikim Kombëtar i Kombinuar (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional deri me njëzetepesë (25) nxënës në një klase, dhe mund të ofroj deri ne katër (4) klase brenda vitit, që në total bëjnë 100 nxënës (4x25=100) nxënës për një vit shkollor.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetim

Në bazë të kërkesës së "UBT" SH.P.K. RR. "UKË BYTYQI" NË PRIZREN për riakreditim dhe rekomandimeve të dala nga raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi rivalidimin e kualifikimit, si dhe raporti i ekipit të ekspertëve mbi riakreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit 30.04.2026për kualifikimin: Teknik i Laboratorit Mjekësor, Niveli III dhe IV sipas KKK dhe Bashkëpunëtor profesional i infermierisë, Niveli III dhe IV sipas KKK ndërsa vizita është realizuar me datën 04.05.2026Pas përfundimit të procesit vlerësues, raportet janë realizuar me datë: 18.05.2026, Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 29.05.2026

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për rivalidim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për riakreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. "UBT" SH.P.K. RR. "UKË BYTYQI" NË PRIZREN.
2. Arkivit të AKK.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK